



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi 7 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenin 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror duke vepruar pas denoncimit nga parashtrues i panjohur, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në senacën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, morri

#### VENDIM

**NDËRPRITET** procedura për përcaktim të konfliktit të inteersave kundër personit ....., kryetarë i Gjykatës së apelit ....., sepse nuk janë vërtetuar akuzat nga denoncimi dhe nuk është vërtetuar konflikti i interesave.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 09-3438/1 me datë 05.07.2019.

Lënda me numër 09-3438/1 me datë 05.07.2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

#### SQARIM

Lënda me numër 09-3438/1 me datë 05.07.2019 e formuar në bazë të denoncimit anonim kundër personit ....., kryetarë i ..... në Manastir, me akuzat se kah fundi i viti 2018, në këtë gjykatë është shpallur konkurs për punësim dhe janë punësuar dy persona: ..... dhe ....., persona të afërt të njërit nga gjyqtarët në Gjykatën themelore ..... dhe Prokuror i lartë publik nga .....

Gjithashtu, parashtruesi tregon edhe në atë se gjyqtari ..... nga Gjykata e apelit ..... nuk ka paraqitur ndryshim të gjendjes së pronës, kurse bashkëshorti i saj gjatë vitit 2017 me kontratë për shitë-blerje ka blerë shtëpi në fshatin Bukovë.

Në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, në përputhje me nenin 76 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek ..... në Manastir në lidhje me atë se vallë personat ..... dhe ..... janë të punësuar në këtë gjykatë, pas të cilës KSHPK është informuar se të njëjtin nuk janë të punësuar në këtë institucion.

Në seancën e mbajtur me datë 12.02.2021, pas shqyrtimit të të gjitha akuzave të lëndës, Komisioni shtetëror duke u nisur në dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, konstaton, të ndërpritet procedura për përcaktim të konfliktit të interesave kundër personit ....., kryetarë i Gjykatës së apelit në ....., sepse nuk janë vërtetuar akuzat nga denoncimi.

Në lidhje me akuzat nga denoncimi kundër gjyqtarit ....., KSHPK do të bëjë kontrollime në bazën e të dhënave për fletë-ankesat e dorëzuara dhe deklaratat për interesa.

Në bazë të të theksuarës më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: K. Z., këshilltarë  
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK

